



Planuar / Dorezuar Punje/Prodato Received/Delivered	03-04-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot in Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3275/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.364/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.364/2023 të datës 16.02.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, me adresë f.sh. Gojbul Komuna e Vushtrrisë, kundër Vendimit me numër protokollit 02/2023 të datës 31.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.364/2023 e datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesja _____

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokollit 02/2023 i datës 31.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile _____ e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 16.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1848/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 02/2023 i datës 31.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.02.2023 me numër protokolli 2137/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 07.03.2023 me numër protokolli 2431/2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1848/2023 e datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor me numër protokolli 02/2023 i datës 31.01.2023; Shkresë me titull misioni eulex në Kosovë pa datë e S.M.; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2137/2023 i datës 27.02.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 2431/2023 i datës 07.03.2023; Akt Emërim i S. M me numër protokolli 02/931/11 i datës 29.02.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Inspektor Tatimor i datës 02.07.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i ekipit për kontroll; Procesverbal i seancës të komisionit disiplinor i datës 26.01.2023; Shkresë përcjellëse për KD me numër protokolli 20 i datës 13.12.2022; Kërkesë për trajtim të rastit nga komisioni disiplinor sipas rekomandimeve ne raportin e rastit 15/22-DSP ndaj S. M me numër protokolli 11.06-4591 i datës 13.12.2022; E-mail nga A. S.K. për A. S .etj. i datës 13.12.2022; E-mail nga A.S. për N.G. etj. i datës 12.12.2022; Raport për rastin nr.15/22-S. M i datës 13.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 30.11.2022; E-mail nga S.M. për predstavkegradjana@predsednik.rs i datës 29.11.2022; Të dhënat e punëtorit S.M. i datës 2014; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. etj. i datës 30.11.2022; E-mail nga S.M. për predstavkegradjana@predsednik.rs i datës 29.11.2022; E-mail nga R.H. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për vladacalicspo@gmail.com i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për zkip.zkm@rks-gov.net i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për M.H. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për M.H. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S.K për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 30.11.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga I.M. për A.S. etj. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për I.M. etj. i datës 06.12.2022; E-mail nga S. M për zkip.zkm@rks-gov.net i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-

mail nga A.S për I.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga I.M. për A.S. etj. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për I.M. etj. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për zkp.zkm@rks-gov.net i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet@spo.rs i datës 06.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S.K. i datës 07.12.2022; E-mail nga A.S.K. për F.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga T.M. për A.S. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 30.11.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 07.12.2022; E-mail nga A.S. për I.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga I.M. për A.S. etj. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për I.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për zkp i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet i datës 06.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S.K. i datës 07.12.2022; E-mail nga A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga T.M. për A.S. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për I.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për zkp i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 30.11.2022; E-mail nga S.M. për predstavkegradjana i datës 29.11.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 07.12.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S.K. për B.D. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për R.H. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 30.11.2022; E-mail nga S.M. për predstavkegradjana i datës 29.11.2022; E-mail nga A.S.K. për B.H. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 05.12.2022; E-mail nga F.M. për A.S. i datës 05.12.2022; E-mail nga A.S. për F.M. i datës 02.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 02.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 30.11.2022; E-mail nga S.M. për predstavkegradjana i datës 29.11.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 06.12.2022; E-mail nga M.H. për B.H. i datës 06.10.2021; E-mail nga M.H. për B.H. i datës 06.10.2021; E-mail nga A.H. për A.S. i datës 06.12.2022; E-mail nga A.S. për I.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga I.M. për A.S. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për I.M. i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për zkp i datës 06.12.2022; E-mail nga S.M. për kabinet i datës 06.12.2022; E-mail nga B.D. për A.S.K. i datës 07.12.2022; E-mail nga K.B. për Administratoret e sistemiit të TI-së i datës 07.12.2022; E-mail nga A.H. për K.B. i datës 07.12.2022; E-mail nga B.H. për Standardet profesionale i datës 07.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 06.12.2022;

E-mail nga F.M. për Standardet profesionale i datës 07.12.2022; E-mail nga Standardet profesionale për F.M. i datës 07.12.2022; E-mail nga B.H. për Standardet profesionale i datës 07.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 06.12.2022; E-mail nga Standardet profesionale për F.M. i datës 07.12.2022; E-mail nga B.H. për Standardet profesionale i datës 07.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 06.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 07.12.2022; E-mail nga A.S. për B.H. i datës 07.12.2022; E-mail nga B..H. për A.S. i datës 07.12.2022; E-mail nga A.S. për A.S.K. i datës 07.12.2022; E-mail nga B.H. për A.S. i datës 07.12.2022; E-mail nga B.H. për Standardet profesionale i datës 09.12.2022; E-mail nga F.Z. për B.H. i datës 08.12.2022; E-mail nga F.Z. për B.H. i datës 08.12.2022; E-mail nga Standardet profesionale për A.S.K. i datës 12.12.2022; E-mail nga B.H. për Standardet profesionale i datës 07.12.2022; E-mail nga S.M. për B.H. i datës 06.12.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e pa bazuar, SEPSE:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit me numër protokollit 02/931/11 të datës 29.12.2012 mbanë pozitën "*Inspektore Tatimore*" në Departamentin Tatimor Rajonal në Mitrovicë.

Më tej nga provat e lëndës rrjedhë se Drejtori Rajonal në Mitrovicë, me datë 02.12.2022 ka iniciuar kërkesë pranë Divizionit për Standarde Profesionale në ATK, për hetim të sjelljeve të ankueses lidhur me keqpërdorimin e e-mailit zyrtar, ndërsa Divizioni për Standarde Profesionale përmes raportit me referencë rasti Nr. 15/22 DSP të datës 13.12.2022 ka konstatuar se ankuesja ka kryer shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 në 3.6, 3.7, 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që e njëjta me veprimet e saj duke përdorur e-mailin zyrtar ka dërguar shkresa me përmbajtje që nuk kanë të bëjnë me detyrën e saj zyrtare dhe me këto veprime ka keqpërdorur pasuritë e institucionit si kompjuter dhe adresën e e-mailit zyrtar, duke rekomanduar që ndaj ankueses të iniciohet procedurë disiplinore në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa Komisioni Disiplinor duke u bazuar në nenin 48 paragrafi 5 të këtij ligji, me vendimin me Nr.13/2022 të datës 15.12.2022 ka vendosur për pezullimin e ankueses nga detyra deri në marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë.

Ndërsa më datën 31.01.2023 me nr. protokollit 02/2023 Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës ka nxjerr vendim me të cilin vendim ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim i 40% të pagës për një periudhë për gjashtë (6) muaj", ku sipas pikës tre (3) të vendimit e ka shfuqizuar vendimin paraprak me nr. 11/22 të datës 15.12.2022 për suspendimin e ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin e datës 31.01.2023 me nr. protokollit 02/2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 02/2023 i datës 31.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

Me datë 13.12.2022 Udhëheqësi i Divizionit të Standarde Profesionale në ATK ka bërë kërkesë për trajtimin e rastit sipas rekomandimeve të Raportit 15/22-DSP e dërguar në Komisioni Disiplinor përmes Divizionit të Burimeve Njerëzore për inicimin e procedurave disiplinore ndaj ankueses Snezana Miliq "Inspektore Tatimore" në Departamentin Tatimor Rajonal në Mitrovicë për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46, paragrafi 3, 3.6, 3.7, dhe 3.10 në mbështetje të nenit 48, paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 11 si dhe nenin 12 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerr vendim me numër protokolli 02/2023 me datë 31.01.2023 ku ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore për shkak të detyrimeve nga neni 27, paragrafi 1,2 dhe 3 dhe neni 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, të shkeljes së dispozitave ligjore sipas nenit 46 paragrafi 3, nën paragrafi 3.6, 3.7 dhe 3.10 të Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, të shkeljeve të rregullave sipas nenit 5 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës dhe të shkeljes së rregullave të brendshme për zyrtarë tatimor sipas nenit 11 paragrafi 5 dhe 6 të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës, ku ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim i 40% të pagës për një periudhë për gjashtë (6) muaj".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja ka keqpërdorur pasurit e institucionit për qëllime jozyrtare (Kompjuterin, E-mailin dhe orarin e punës), ka dhënë mendime politike gjatë orarit të punës duke përdorur pasuritë zyrtare, është marrë nga Policia e Kosovës për intervistim pasi me veprimet e saj me datë 07.12.2022 para objektit ka provuar ta cenoj integritetin e institucionit dhe zyrtarëve të këtij institucioni, me dashje në cilësinë e zyrtares së ATK me e-mail zyrtar dhe për çështje personale znj. _____ i është drejtuar institucioneve të shtetit të Serbisë, po ashtu këto e-maile i ka ridërguar edhe në nivelet qendrore të Republikës së Kosovës, zyrës së Kryeministrit të Kosovës, Ministrinë të Financave dhe zyrtarëve të lartë në ATK, ndërsa e-maili i datë 06.12.2022 përmban edhe shkrime fyese duke ju referuar shtetit të Kosovës si "Kosova Metohija", në këtë e-mail po ashtu ka kërkuar nga shteti Serb që ti jepej leja që të kandidoj për Kryetare të Komunës së Mitrovicës.

Ankuesja me datë 06.12.2022 përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar Drejtorit të Departamentit Drejtoria Rajonale - Kontrolli duke ju drejtuar se: *I nderuar Drejtor mendova se çfarëdo që të bëjë gjatë orarit të punës në ATK, duhet t'i informoj të gjitha autoritetet, dhe së pari ju kërkoj falje sinqerisht, nuk kam menduar se është keqpërdorim i detyrës së pozitës time zyrtare, kam gabuar dhe unë sinqerisht dua të kërkoj falje para së gjithash për ju dhe për të gjithë të tjerët të cilëve u dërgova një e-mail sot. Unë dua të mbaj përgjegjësi për gjithçka që kam bërë. Ua lë drejtorëve që të aplikoni sanksione ndaj inspektorit tatimor në bazë të ligjit të ATK-së.*

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, konkretisht Kolegji

analizoj: Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: "shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delhur në punë" ndërsa "Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".

Nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor".

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh të gjitha këto prova të lëndës, konstaton se ankuesja me veprimet e saj, ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6, 3.7 dhe 3.10 dhe 4.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse me veprimet e saj ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2, nenin 27 paragrafi 1 dhe 2, 3 dhe nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "neni 25 paragrafi 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. Neni 27 paragrafi 1, 2 dhe 3 1. Zyrtari publik është i obliguar të menaxhojë me kujdes pasurinë shtetërore, që i vihet në detyrim për ushtrimin e detyrës dhe të përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar me ligj dhe sipas rregullave të brendshme të institucionit. 2. Zyrtarit publik nuk i lejohet të shfrytëzojë pasurinë shtetërore si mjet për zhvillimin e

veprimtarisë personale ekonomike ose të aktiviteteve të paligjshme. 3. Zyrtari publik është i detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij të punës dhe neni 28 Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij. Si rezultat i kësaj ankuesja ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6, 3.7 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.


Nga të cekurat më lartë Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 02/2023 të datës 31.01.2023, ka vepruar në pajtim me nenin 45, 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 nenin 48 paragrafi 3, të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat të nenit 11, 12, 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa arsyetimi i vendimit është në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë Kolegji, konstaton se pretendimet e ankueses ndaj kësaj mase janë të pabazuara.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.364/2023.

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.